
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

Datë/a:	06.01.2020
Për/ Za/ To:	“Sinjalizimi SHPK&Hysen Sopa B.I.”
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës-ankeses për ri-shqyrtim** të datës 03.01.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Sinjalizimi SHPK&Hysen Sopa B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunen e Prishtinës-pjesa e dyte”**, me Nr. të Prok: **616 19 8007 111** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “Sinjalizimi SHPK&Hysen Sopa B.I.” e dates 03.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunen e Prishtinës-pjesa e dyte” me numer 616 19 8007 111 , kundër Vendimit të AK -së, të datës 30.12.2019.**
2. **Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 30.12.2019.**
3. **Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunen e Prishtinës-pjesa e dyte” ta vazhdoj sipas njoftimit të dates 30.12.2019.**
4. **Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 06.01.2019 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave te adresave ne Komunen e Prishtines-pjesa e dyte” me Nr. 616 19 8007 111, procedura e hapur.**

Me datë 30.12.2019, Autoriteti Kontraktues ka ngritur Njoftimin për Vendimin e AK.

OE “Sinjalizimi SHPK&Hysen Sopa B.I.”, me dt. 03.01.2020, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim edhe pse jo ne formularin standard, sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave te adresave ne Komunen e Prishtines-pjesa e dyte**, kundër vendimit të AK, në të cilin theksohet se AK ka *shkelur dispozitat e LPP, respektivisht se eshte eliminuar pa te drejte sepse ka dorezuar sigurimin e tenderit ne formen e duhur.*

Lidhur me kete iu sqarojme si vijon:

Sigurimi i tenderit i duhet te dorezohet ne formen e kerkuar dhe nese jo nuk mund te kerkohen sqarime sipas nenit 39 te RUOPP.

Neni 39 i RUOPP

Problemi	Si te veprohet?	Neni i LPP-se
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

Si rrjedhoje, oferta juaj është eliminuar pasi që nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesën e parashtruar në DT si dhe, në përputhje me nenin 39 të RUOPP dhe nuk përmban kushtet e përcaktuara në formën standarde të DT, dhe i cili nen decidivisht percakton se nëse mungojnë kushtet e përcaktuara, **AK duhet te refuzoj tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm.**

Ju, ne kërkesën për rishqyrtim:

- ✓ keni deklaruar, se Polisa e sigurimit, e dorëzuar me oferte, i posedon të gjitha të dhënat e Sigurimit të Tenderit.
- ✓ AK, rikonfirmon, se Polisa e sigurimit, e dorëzuar me oferte, **NUK i përmban kushtet e përcaktuara** (3 kushtet e përcaktuara në formën standarde të DT, që mund të shihet nga përmbajtja e garancionit nga Dosja e tenderit:

Garancion me kërkesë te pare

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: **< shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra >** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
 - Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
 - Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuar në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej: **<shuma e garantuar>** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen deri me: **<data dhe koha >**

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Kjo tregon qarte se ju nuk keni dorezuar sigurimin e tenderit me formën dhe përmbajtjen e duhur.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

